



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.10.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "DWH ALBANIA" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "DWH-ALBANIA" SH.P.K. e dt.25.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 04.08.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, i publikuar me datë: 04.08.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Arsyetim

Me dt.25.10.2022, Operatori Ekonomik " DWH ALBANIA" SH.P.K ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me instrument GPS " , Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.10.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Softueri te jete i hapur për çdo pune gjeodezike! Kërkesa është shumë e qarte.
2. Nuk është aspak antiligjore një kërkesë që të gjithë produktet të jene nga një prodhues, sepse lehtëson punën tone! Kjo kërkesë vjen për shkak të ndërveprimit të produkteve mes vete! Te kenë një intuitë përdorimi dhe një softuer, një shërbim!
3. Është konsumuar si pyetje kjo e memories se brendshme dhe të jashtme! Ju lutemi kërkojeni përgjigjet nga eksperti i OSHP-se!
4. Formatet janë kërkuar ato formate që neve na duhen patjetër!
5. Pyetja për trajtimin e specifikave teknike në vetvete është e paraqartë, të gjitha karakteristikat dhe specifikat për instrumentet në I kemi prezantuar më herët dhe ato duhet të na ofrohen!

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës